

IFLETËUDHËZUES I PAKETIMIT: Informacion për përdoruesin

METYSOLON

Tableta – 4 mg

Metilprednizolon

Lexojeni me kujdes fletëudhëzuesin përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Rruajeni fletëudhëzuesin. Mund t’ju nevojitet ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje të tjera, drejtohuni tek mjeku ose farmacisti juaj.
- Ky bar është përshkruar për ju personalisht. Mos ja jepni personave të tjerë. Mund t’i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Nëse ndonjë prej efektëve anësorë të përmendura ju shqetëson ose nëse vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Ky fletëudhëzues përmban:

- Çfarë është Metysolon dhe përse përdoret?**
- Çfarë duhet të kini kujdes përpara se të merrni Metysolon?**
- Si ta marrni Metysolon?**
- Efekte anësore të mundshme**
- Si ta ruani Metysolon?**
- Informacione të mëtejshme**

1. ÇFARË ËSHTË METYSOLON DHE PËRSE PËRDORET?

Metysolon përmban lëndën vepruese metilprednizolon, që është një glukokortikoid (hormon i gjendrës mbiveshkore) që vepron në metabolizëm, ekuilibrin e kripës (elektroliteve) dhe funksionin e indëve. Metysolon përdoret në sëmundjet që kanë nevojë për trajtim sistematik me glukokortikoidë. Sipas formës që shfaqen dhe shkallës së gravitetit, këtu bëjnë pjesë p.sh.:

Sëmundje reumatike

- artrit reumatoid aktiv me formë të rëndë progresive, p.sh. format e shpejtë destruktive ose format që nuk kanë prekur kytet;
- artrit pa shkak të njohur tek të rinjtë (artrit idiopatik juvenil) me forma të rënda që prekin organet e brendshme (sindromi Still) ose me prekje të syrit që nuk kontrollohet me trajtim lokal (inflamacion i irisit dhe zonës përreth, iridocikliti).

Sëmundje të bronkeve dhe të mushkërive

- astma bronkiale, rekomandohet njëkohësisht përdorimi i barnave bronkodilatatore;
- përqësimi akut i sëmundjes obstruktive kronike, kohëzgjatja e rekomanduar e trajtimit deri në 10 ditë;
- sëmundje specifike të mushkërive, si: inflamacion akut i alveolave (alveolit), fibrozë pulmonare, trajtim afatgjatë i fllamave kronike të sarkoidozës në stadin II dhe III (marrje fryme, kollë dhe përqësim i vlerave të funksionit të mushkërisë).

Sëmundje të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes

Forma të rënda progresive të etheve nga bari dhe rinitt alergjik, pasi terapia me glukokortikoidë nazalë ka dështuar.

Sëmundje të lëkurës

- Sëmundje të lëkurës dhe mukozave, që për shkak të gravitetit të tyre dhe / ose përhapjes ose prekjës së organeve të brendshme, nuk mund të trajtohen në mënyrë të kënaqshme me glukokortikoidë lokale. Kështu përshihen:
- reaksiione alergjike dhe reaksione të ngjashme me ato alergjike, reaksione alergjike të shoqëruara me infeksione: p.sh. urtikarie akute, reaksione të ngjashme me shokun (anafilaktike);
 - sëmundje të rënda të lëkurës që e dëmtojnë pjesërisht atë, rash i shkakuar nga barnat, eritemë ekzudative multiforme, nekrolizë epidermale toksike (sindrom Lyell), eritema nodoze, ekzëmë kontakti alergjike;
 - inflamacion i enëve të gjakut (vaskulit), p.sh. vaskulitit alergjik, poliarteriti nodoz;
 - sëmundje të sistemit imun (sëmundje autoimmune): p.sh. dermatomiotit, sklerodermë sistematike (faza indurative), lupus eritematoz kronik diskoid dhe subakut kutanë.

Sëmundje të gjakut / Sëmundje tumorale

- Sëmundje autoimmune të gjakut: anemi për shkak të vetëshkatërrimit të eritrociteve (anemi hemolitike autoimmune);
- parandalim dhe trajtim i të vjellave me shkaktuara nga kemoterapia në regjimet antiemetike (në kombinim me produktat të tjera mjekësore).

Sëmundje gastrointestinale

- Kolit ulçeröz;
- sëmundja Crohn.

Terapi zëvendësuese hormonale

Në rastin e funksionit të ulur të mbiveshkoreve ose në pamjaftueshmërinë e tyre, cildo qoftë shkaku (p.sh. sëmundja e Addisonit, sindroma adrenogenitale, heqja kirurgjike e mbiveshkoreve, funksion i ulur i gjendrës së hipofizës) pas moshës së rritjes (barnat e zgjedhjes së parë janë hidrokorizoni dhe kortizoni).

Metysolon 4 mg mund të përdoret gjithashtu:

- për të frenuar mbrojtjen e trupit (mnosupresion) pas transplantit, në kontekstin e terapive të kombinuara konvencionale,
- si një masë plotësuese në terapi me citostatike ose radioterapi në skemat ekzistuese për terapi të kombinuar, terapi paliative (trajtim për lehtësimin e sëmundjes) dhe terapi antiemetike (trajtim kundër të vjellave).

2. ÇFARË DUHET TË KINI KUJDES PËRPARA SE TË MERRNI METYSOLON?

Metysolon nuk duhet të përdoret, nëse jeni i mbingjeshëm (alergjik) ndaj metilprednizolonit, glukokortikoidëve të tjerë ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Metysolon 4 mg. Përveç reaksioneve alergjike, nuk ka kundërlindikacione gjatë përdorimit afatshkurter të Metysolon 4 mg në situata akute kërcënuese për jetën ose kur administrohet si terapi zëvendësuese hormonale.

Tregoni kujdes të veçantë përpara se të merrni Metysolon

Filsi me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni Metysolon nëse nevojiten doza më të larta sesa ato të terapisë zëvendësuese hormonale. Për infeksione të rënda Metysolon mund të përdoret vetëm në kombinim me një trajtim të shënjestruar kundër agjentëve infektivë.

Metysolon 4 mg duhet të përdoret vetëm nëse mjeku i sheh të domosdoshme në sëmundjet e mëposhtme. Nëse është e nevojshme, njëkohësisht duhet të merren barna kundër shkakarit të sëmundjes.

- infeksione virale akute (p.sh. illa, zjarrj i natës, infeksione nga herpes - simpleks, inflamacion i kornesë së syrit i shkakuar nga herpes viruset);
- infeksione bakteriale akute dhe kronike;
- sëmundje mykotike që prekin organet e brendshme;
- sëmundje specifike të shkaktuara nga parazitë (ameba, infeksione nga krimbat);
- sëmundje e nyjeve limfatike pas vaksinimit për tuberkuloz;
- nëse ka tuberkuloz në anamnezë, duhet që njëkohësisht të merren barna kundër të dhe është e nevojshme mbikqyrja e kujdeshme mjekësore; inflamacion infeksioz i mëlçisë (hepatit aktiv kronik HBsAg-pozitiv);
- poliomielit;
- afërsisht 8 javë përpara deri 2 javë pas vaksinimit me vakina të gjalla. Gjithashtu, Metysolon duhet të merret në sëmundjet e mëposhme vetëm nëse mjeku e konsideron të domosdoshme dhe nëse këto sëmundje trajtohen njëkohësisht me mënyrën e duhur:
- ulçera gastrointestinale;
- presion i lartë i gjakut që stabilizohet me vështirësi;
- sëmundje e sheqerit në shkallë të rëndë (diabet mellitus);
- humbje e madhe e masës kockore (osteoporozë);
- sëmundje mendore (psikike) (edhe në anamnezë);
- presion i rritur intraokular (glaukomë me kënd të gjerë dhe të ngushtë);
- dëmtime dhe ulçera të kornesë së syrit.

Për shkak të rezikut të çarjes së murit të zorrës dhe peritonitit, Metysolon mund të përdoret vetëm për arsye të detyrueshme mjekësore dhe nën mbikqyrje të kujdeshme në:

- inflamacion të rëndë të kolonit (kolit ulçeröz) me rezik çarjeje, me abscese ose inflamacione purulente;
- protuberanca të infllamua të murit të zorrës (divertikulit);
- rastet pas operacioneve specifike në zorrë (enteroanastomoza) menjëherë pas operacionit.

Nëse keni turbullim të shikimit ose probleme të tjera të tij, kontaktoni mjekun tuaj.

Shenjat e irritimit peritoneal të shkaktuara nga çarja si pasojë e ulçerës gastrointestinale mund të mungojnë në pacientët që marrin doza të larta të glukokortikoidëve. Në sëmundjen e sheqerit duhet të kontrollohet rregullisht metabolizmi; duhet të mbahet parasysh një nevojë e mundshme e rritur për barnat që trajtojnë sëmundjen e sheqerit (insulinë, tableta etj.). Nëse keni presion të lartë të gjakut ose pamjaftueshmëri të rëndë të funksionit të zemrës, bëni kontrolle të rregullta mjekësore sepse ekziston rezikui i përqësimt. Pas përdorimit të kortikosteroidëve, është raportuar shfaqja e të ashtuqua-jturës krizë e feokromocitomës (shih pikën 4. "Efekte anësore të mundshme"), e karakterizuar p.sh. nga një rritje e dukshme e presionit të gjakut me dhimbje koke, djersitje, palpitacione dhe zbeheje të lëkurës, që mund të jetë fatale. Kortikosteroidët duhet të përdoren vetëm pas një vlerësimi të arsyeshëm të raportit risk - përfitim tek pacientët me feokromocitomë (tumor hormon -

formues zakonisht në palcën e mbiveshkoreve) të dyshuar ose të njohur. Ka pasur raportime që kortikosteroidët shkaktojnë mpikseje gjaku (trombozë) dhe bllokim të enëve të gjakut për shkak të mpikjesës së gjakut në sistemin venoz (tromboemboli venozë). Filsi me mjekun tuaj nëse keni një gjendje të shkakuar nga një bllokim i enëve të gjakut prej mpikjesës së gjakut, ose nëse dyshoni për këtë. Në këto raste, trajtimi me Metysolon 4 mg duhet të bëhet me kujdes.

Gjatë trajtimit të një lloj paralize muskulare (Miaestenia gravis), në fillim të saj, mund të ndodhë një përqësim i simptomave, që mund të çojë në krizë miastenike, prandaj stabilizimi i dozës së Metysolon duhet të bëhet në spital. Veçanërisht, kur shqetësimet në fytyrë dhe grykë janë të rënda dhe kur preket frymëmarrja, trajtimi me Metysolon 4 mg duhet filluar me shumë kujdes.

Metysolon mund të maskojë shenjat e infeksionit, duke vështirësuar në këtë mënyrë përcaktimin e një infeksioni ekzistues ose që po zhvillohet. Trajtimi me një glukokortikoid si Metysolon 4 mg, përmes imunosupresionit, on në rritje të riskut për infeksione edhe nga ata shkaktarë të cilët në kushte të tjera rralë shkaktojnë infeksione (të ashtuquajturat mikrobe oportuniste).

Përgjithësisht, vaksinat që përmbajnë mikroorganizma jo të gjallë, mund të bëhen. Gjithsesi, duhet bërë kujdes sepse kur merren doza të larta të Metysolon, mund të cenohet suksesi i vaksinimit. Prandaj, vaksinimi nuk rekomandohet tek pacientët që marrin trajtim me doza të larta (përveç terapisë zëvendësuese). Trajtimi sistematik me glukokortikoidë mund të nxist një sëmundje të korodit dhe tënës së syrit (korioretinopati), e cila mund të çojë në gregullime të shikimit duke përfshirë humbjen e shikimit. Trajtimi i zgjatim sistematik me glukokortikoidë mund të shkaktojë korioretinopati, madje edhe në doza të ulëta (shih pikën 4. "Efekte anësore të mundshme"). Në terapinë e zgjatuar me Metysolon janë të nevojshëm kontrolle të rregullta mjekësore (përfshirë kontrollin e syve).

Veçanërisht në përdorimet e zgjatura dhe me doza relativisht të larta të Metysolon 4 mg, tregoni kujdes për marrje të mjaftueshme të kalciumit (p.sh. perime, banane) dhe marrje të kujfuar të kripës. Kontrolloni nivelin e kaliumit në gjak.

Nëse gjatë trajtimit me Metysolon kalohen stresse të caktuara fizike, si: sëmundje që shoqërohen me temperaturë, aksidente ose operacione, duhet njoftuar menjëherë mjeku ose mjekui i urgjencës për tu informuar miri vazhdimin e trajtimit. Mund të jetë e nevojshme një rritje kalimtare e dozës ditore të Metysolon. Në trajtimin për kohë të gjatë me Metysolon 4 mg, mjeku duhet t’ju pajisë me një kartë kortikosteroidësh të cilën duhet ta mbani gjithmonë me vete. Në varësi të dozimit dhe kohëzgjatjes së trajtimit, duhet mbajtur parasysh një ndikim negativ mbi metabolizmin e kaliumit, kështu që rekomandohet trajtim parandalues për osteoporozën. Kjo vlen më së shumti kur njëkohësisht ka faktorë risk, si: predispozitë familjare, moshë e avancuar, marrje e pamjaftueshme e proteinave dhe e kaliumit, duhanpënie e theksuar, konsum i tepërt alkooli, periudhë pas menopauzës si dhe mungesë e aktivitetit fizik. Parandalimi konsiston në marrjen e mjaftueshme të kaliumit dhe vitaminës D si dhe në kryerjen e aktivitetit fizik. Nëse osteoporozza është tashmë prezente, duhet të merret trajtim shtesë për të.

Në përfundim ose në rast se ndërpritet trajtimi afatgjatë me Metysolon, duhen mbajtur parasysh rreziqet e mëposhtëm: recidive ose përqësimi i sëmundjes bazë, hipofunksion akut i mbiveshkoreve, (kryesisht në situata stresi, p.sh. gjatë një infeksioni, pas aksidentave, në ngarkesë të situat fizike), shenja dhe simptoma të ndërprerjes së kortizonit. Tek pacientët që trajtohen me Metysolon, sëmundjet virale mund të shfaqen me forma veçanërisht të rënda, në disa raste edhe kërcënuese për jetën. Më të rezikuar janë fëmijët me imunitet të dobësuar si dhe personat që nuk janë prekur më parë nga fruthi ose illa. Nëse këta persona, gjatë kohës që trajtohen me Metysolon, kanë kontakt me persona të tjerë të sëmurë nga fruthi, illa ose zjarrj i natës, duhet të shkojnë menjëherë tek mjeku për të marrë trajtim parandalues nëse duhet.

Rrallë, janë raportuar gregullime të mëlçisë dhe tëmthit, shumica e të cilave janë zhdukur pas ndërprerjes së trajtimit. Prandaj, është e nevojshme mbikqyrja përkatëse mjekësore (shih pikën 4 "Efekte anësore të mundshme"). Në pacientët me hipotiroidizëm që nuk kompensohet me barna, ose me dirozë të mëlçisë, mund të jetë të mjaftueshme doza relativisht të ulëta dhe një reduktim i përgjithshëm i dozës mund të jetë i nevojshëm. Duhet të sigurohet mbikqyrja mjekësore e kujdeshme.

Fëmijët

Tek fëmijët, për shkak të rezikut të frenimit të rritjes, Metysolon duhet përdorur vetëm për arsye të domosdoshme mjekësore dhe rritja në gjatësi duhet të kontrollohet vazhdimisht.

Efektet e keqpërdorimit për qëllime dopingu

Përdorimi i Metysolon mund të japë rezultate pozitive në kontrollet e dopingut. Përveç kësaj, keqpërdorimi i Metysolon si një agjent dopingu mund të rezikojë shëndetin tuaj.

Marrja e Metysolon me barna të tjera

Ju lutemi të informoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse merrni / përdorni, keni marrë / përdorur së fundmi ose keni ndërmend të merrni / përdorni barna të tjera, edhe nëse bëhet fjalë për barna të marra pa recetë.

Cilat barna të tjera ndikojnë në veprimin e Metysolon?

Thëksim i efektit dhe ndoshta i efektëve anësore:

- barnat që ngadalësojnë metabolizmin në mëlçi, si disa barna anti-mykotike (ketokonazol, itraconazol); efekt i kortikosteroidëve mund të rritet;
- disa hormone seksuale femërore, p.sh. për parandalimin e shtatzënise (pilula); efekt i Metysolon mund të theksohet;
- disa barna mund të risin efektet e Metysolon dhe mjeku juaj mund t’ju mbikqyrë në mënyrë të kujdeshme nëse po i merrni ato (duke përfshirë disa barna për trajtimin e HIV: ritonavir, kobicitat).

Dobësim i efektit:

- barnat që përshpejtojnë metabolizmin në mëlçi (p.sh. barbiturate (barna gjumësjellëse), fenitoina, primidoni, karbamazepina (barna kundër epilepsisë), rifampicina (bar kundër tuberkulozit)); mund të ulët efektin i Metysolon;
- barnat që përmbajnë efedrinë për enjtje të mukozave: metabolizmi i glukokortikoidëve mund të përshpejtohet dhe efikasiteti i tyre të dobësohet.

Ndërveprime të tjera të mundshme:

- barna të përdorura për trajtimin e sëmundjeve të zemrës (p.sh. diltiazem [blokues i kanaleve të kaliumit]); degradimi i metilprednizolonit ngadalësohet; në fillim të trajtimit me Metysolon, duhet të sigurohet mbikqyrja mjekësore; mund të kërkohet një rregullim i dozës së metilprednizolonit;
- antiacide që përmbajnë hidroksid alumini (barna për prodhimin e tepërt të acidit të stomakut) zvogëlojnë biodisponibilitetin e prednizolit. Nuk ka studime përkatëse për metilprednizolonin. Prandaj, ndërveprimet nuk mund të përjashtohen në mënyrë të sigurtë. Rekomandohet që të merrni barnat me një interval kohe prej rreth 2 orësh.

Si ndikon Metysolon në veprimin e barnave të tjera?

Thëksim i efektit dhe ndoshta i efektëve anësore:

- barna për forcimin e zemrës (glikozidet kardiake): veprimi i tyre mund të përforcohet për shkak të mungesës së kaliumit që mund të shkaktojë Metysolon;
- barna diuretike dhe laktative (salkuretë) / laktativë): efekt i tyre në eliminimin e kaliumit mund të theksohet;
- barna të caktuara që shkaktojnë relaksim të muskujve (miorelaksantët jodeopolarizues): relaksimi i muskujve mund të zgjasë më shumë (shih pikën 4 "Efekte anësore të mundshme";

Dobësim i efektit:

- barna që ulin sheqerin në gjak (antidiabetikë / insulinë): mund të ulët efekti antidiabetik;
- barna antikoagulante (antikoagulantë oralë derivatë të kumarinave): mund të dobësohet efekti antikoagulant;
- barna kundër sëmundjeve parazitare (prazikuantel): mund të zvogëlohet efekti i këti bar;
- hormoni i rritjes (somatropin): efekt i saj mund të pakësohet;
- proterelinë (hormon i trurit të mesëm): pakësohet rritja e hormonit stimules të tiroides (TSH);

Ndërveprime të tjera të mundshme:

- barna kundër inflamacionit dhe reumatizmit (salicilate, indometacinë dhe antinfllamatorë të tjerë josteroidë): mund të rritet rezikui për ulçera peptike dhe hemorragji gastrointestinale;
- barna të caktuara oftalmologjike (atropinë) dhe barna me veprim të ngjashëm (antikolinergjikë të tjerë): mund të ndodhë rritje shtesë e presionit intraokular;
- barna kundër malaries ose sëmundjeve reumatike (klorokinë, hidroksid lorokinë, meflokinë): ekziston risk i rritur për shfaqjen e sëmundjeve muskulare ose sëmundjeve të muskullit të zemrës;
- ciklosporinë (bar për suprimimin e sistemit imun): niveli i ciklosporinës në gjak mund të rritet, kështu që ekziston një risk i rritur për konvulsione;
- barna të caktuara për uljen e presionit të lartë të gjakut (ACE-inhibitorët): risk i rritur për shfaqjen e gregullimeve në përbërësit e gjakut.

Ndikimi në testet laboratorike:

Përgjigja e lëkurës ndaj testeve të alergjisë mund të frenohet.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gj

Në qoftë se jeni shtatzënë ose po ushqeni fëmijën me gj, mendoni se jeni shtatzënë apo planifikoni të ngeleni shtatzënë, këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni këtë bar. Gjatë shtatzënise përdorimi mund të bëhet vetëm me rekomandimin e mjekut. Përvoja në sigurinë e përdorimit të metilprednizolonit në shtatzëni tek njerëzit është e pamjaftueshme. Nëse gjatë shtatzënise Metysolon përdoret për një kohë të gjatë, nuk

përjashtohen gregullimet e rritjes tek fetusi. Nuk mund të përjashtohet një rritje e rezikut për çarje palatinalë të nollufles tek fetuset njerëzore nga administrimi i glukokortikoidëve gjatë tremujorit të parë të shtatzënise. Nëse Metysolon përdoret në fund të shtatzënise, tek fëmija i palindur mund të shfaqet atrofi e mbiveshkoreve, e cila mund të ketë nevojë për trajtim pas lindjes.

Glukokortikoidët kalojnë në qumështin e gjirit. Nëse për shkak të sëmundjes nevojiten doza më të larta ose terapi e zgjatur, gjidhënia duhet të ndërpritet.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Lidhur me disa efekte anësore, të tilla si reduktimi i mprehtësisë së shikimit (për shkak të opacitimit të lenteve ose rritjes së presionit intraokular), marrje mendsh ose dhimbje koke, Metysolon mund të ndikojë në raste të ralla në aftësinë tuaj për tu përqëndruar dhe për të reaguar. Ju mund të mos reagoni aq shpejt sa duhet ndaj situatave të papritura. Kjo mund të paraqesë rezik, p.sh. në qoftë se drejtoni automjetin ose përdorni makineri. Ju mund të rezikoni vetëm në të tjerët pa nevojë. Këni parasysh që alkooli mund ta përqësojë këtë rezik.

Informacione të rëndësishme për disa nga lëndët ndihmëse të Metysolon Ky bar përmban laktozë. Ju lutemi të merrni Metysolon vetëm pasi të keni biseduar me mjekun nëse jeni në dijeni se vuani nga intolerance ndaj disa sheqernave.

3. SI TA MERRNI METYSOLON?

Gjithmonë merrni Metysolon sipas udhëzimit të mjekut. Dozën do ta përcaktojë mjeku për ju individualisht. Ju lutemi t’i përmbaheni udhëzimeve të përdorimit, përndryshe Metysolon mund të mos japë efektin e pritur. Pyseni mjekun ose farmacistin tuaj nëse nuk jeni i sigur.

Doza varet nga lloji dhe graviteti i sëmundjes si dhe nga reagimi i pacientit. Përgjithësisht, në fillim përdoren doza relativisht të larta, të cilat duhet të jenë më të larta në format e rënda akute në krahasim me sëmundjet kronike. Në varësi të simptomave klinike, mund të kalohet në një dozë mbajtëse më të ulët (përgjithësisht më 4 dhe 12 mg metilprednizolon në ditë). Në mënyrë të veçantë, në sëmundjet kronike, shpesh nevojitet një trajtim afatgjatë me doza më të ulëta mbajtëse.

Doza e rekomanduar është:

Sëmundje reumatike të kyçeve

Fillimisht 4 – 6 tableta Metysolon (16 – 24 mg metilprednizolon) në ditë, nëse janë prekur viscerat, deri në 60 mg metilprednizolon në ditë. Synimi është të arrihet një dozë mbajtëse jo më e lartë se 1 1/2 tableta Metysolon 4 mg (ekuivalente me 4 mg metilprednizolon) në ditë.

Astma bronkiale, sëmundje obstruktive të rrugëve të frymëmarrjes Fillimisht 8 – 10 tableta Metysolon (32 - 40 mg metilprednizolon) në ditë, reduktim i dozës në 8 mg çdo 4 ditë. Pas 3 - 4 javësh terapia përfundon dhe nëse është e nevojshme kalohet në glukokortikoidë me inhalacion. Njëkohësisht rekomandohet përdorimi i bronkodilatatorëve (barna për zgjerimin e bronkeve). Nëse përgjigja nuk është e mjaftueshme, format e rënda të astmës trajtohen me terapi për kohë të gjatë me dozën më të ulët të mundshme prej 1 - 2 tableta Metysolon 4 mg (që i korrespondojnë 4 - 8 mg metilprednizolon) në ditë.

Pas një javë duhet të jetë cikadiene, doza totale ditore duhet të merret në mënjësi njërëshe. Terapi e alternuar (marrja e një dozë dy ditore çdo dy ditë) mund është e mundur zakonisht. Nëse shfaqen simptoma të rënda në darkë ose herët në mëngjes, doza ditore mund të ndahet në 2/3 në mëngjes dhe 1/3 në darkë (në orën 18.00 - 20.00).

Sëmundje intersticiale të mushkërive

Alveolit akut:

Fillimisht 8 - 10 tableta Metysolon (32 - 40 mg metilprednizolon) në ditë për një javë (i ndarë në dy doza nëse është e nevojshme), më pas reduktim i ngadalshëm i dozës deri në përdorimin një herë në ditë.

Fibrozë e mushkërive:

Fillimisht 6 - 8 tableta Metysolon (24 - 32 mg metilprednizolon) në ditë, nëse është e nevojshme i kombinuar me azatiopirin ose penicilaminë. Reduktim i ngadalshëm i dozës deri në dozën mbajtëse individuale prej 1 - 2 tabletash Metysolon 4 mg (ekuivalente me 4 - 8 mg metilprednizolon) në ditë.

Sarkoidozë:

Fillimisht 8 - 10 tableta Metysolon (32 - 40 mg metilprednizolon) në ditë deri në fillimin e efektit, nëse është e nevojshme i ndarë në dy doza. Reduktim i dozës brenda 4 - 6 javëve deri në marrjen një herë në ditë. Format kronike të stadit II dhe III kanë nevojë për terapi afatgjatë me doza ditore 2 - 3 tableta Metysolon 4 mg (ekuivalente me 8 – 12 mg metilprednizolon), ku do preferohet një administrim i alternuar (marrja e një doze dy ditore çdo dy ditë).

Polinozë, Rinjt alergjik

Përveç antihistaminikeve, profilaktikëve me veprim lokal dhe antialergjikëve, kur këta nuk kanë veprim të mjaftueshëm ose kur ekziston rezikui i prekjës së rrugëve të mesme e të vogla të frymëmarrjes: terapi për një kohë të shkurtër fillimisht 4 tableta Metysolon (16 mg metilprednizolon) në ditë, në mënjësi, për 4 ditë (vetëm në raste të veçanta janë të nevojshme doza fillestare më të larta). Reduktim i dozës në 2 tableta Metysolon 4 mg (ekuivalente me 8 mg metilprednizolon) në ditë për 4 ditë të tjera. Terapi përfundon pas 8 ditësh, nëse përgjigja nuk është e mjaftueshme, trajtimi mund të vazhdojë për 1 - 2 javë me 1 - 2 tableta Metysolon 4 mg (që i korrespondojnë 4 - 8 mg metilprednizolon) në ditë.

Sëmundje të lëkurës

Në varësi të gravitetit dhe formës së shfaqjes, fillimisht mund të indikohen 80 - 160 mg metilprednizolon në ditë. Reduktimi i dozës është i shpejtë, kështu që terapia mund të përfundojë përgjithësisht pas 2 - 4 javësh. Vetëm në pak raste është e nevojshme një terapi më e gjatë e cila vazhdon për javë dhe muaj.

Sëmundje autoimmune

Në varësi të gravitetit dhe prekjës së organeve, fillimisht 40 - 160 mg metilprednizolon në ditë, më pas reduktim i ngadalshëm deri në dozën mbajtëse, e cila është e nevojshme të vazhdojë për vite. Në shfaqjet akute mund të jetë e nevojshme një dozë sulmi fillestare.

Crrëgullime të gjakut (Anemi hemolitike autoimmune)

Fillimisht 80 - 160 mg metilprednizolon në ditë, pasi fillon efekti i terapisë (kryesisht brenda 2 javësh), bëhet reduktim i ngadalshëm deri në dozën mbajtëse.